



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 10 TETOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 10.
OKTOBRA 2008. GODINE

TETOR –OKTOBAR
2008

Seanca plenare filloi punën në orën 16,00.

Seancën e kryesoi Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme të plenare të Kuvendit të Kosovës!

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 69 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Ju njoftoj se, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës, për shqyrtim dhe miratim të ligjeve sipas procedurës së veçantë, të datës 15 shkurt 2008, në këtë seancë plenare do procedohet me:

- Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrotjtëse të Kosovës.

Prandaj, do të fillojmë menjëherë me këtë pikë të rendit të ditës.

Komisioni ad-hoc e ka shqyrtuar Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrotjtëse të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj zotin Ramadan Gashi që, në emër të Komisionit ad-hoc, ta arsyetojë Raportin me rekomandime.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj se nëse nuk ka vërejtje nga deputetët, Raporti i Komisionit ad-hoc është i qartë dhe mendojmë se Ligji duhet aprovuar sepse i plotëson të gjitha kriteret.

KRYETARI KUVENDIT: Faleminderit! Atëherë, sipas radhës, shkojmë me shefin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. E ka fjalën, zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: Faleminderit! Zoti Kryetar, ne edhe në shqyrtimin e parë ose në leximin e parë të Ligjit thamë se ky Ligj i plotëson vërtet kriteret e mundshme për rrethanat në të cilat gjendemi.

Prandaj, besoj se me aprovimin e tij do të plotësohen edhe disa nevoja të këtyre djemve që të kalojnë në një trupë tjetër që do të jetë po kështu shumë prestigjioze për Kosovën. Pra, ne jemi për këtë ligj!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Shumë faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe në leximin e parë ne i kemi paraqitur arsyet e njëjta dhe Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet këtë ligj me besim të thellë që, përmes ligjit, t’iu njihet e drejta pjesëtarëve të transformuar të UÇK-së në TMK, si organizatë e suksesshme në misionin e deritashëm që ka pasur.

Tash po punojmë në ndërtimin e strukturave të mbrojtjes dhe të atyre ushtarake. Besojmë se kemi arritur, si parlamant, që së paku atë kategori të pjesëtarëve të TMK-së ta vendosim nën përkujdesje shtetërore. Faleminderit shumë!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së, sikur në seancën e paraditës që u deklarua në favor të miratimit të këtij Ligji, edhe në këtë pjesë, po ashtu, deklarohemi në favor të aprovimit të këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, shumë!

Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, nga AAK.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Njëjtë, sikur në seancën e kaluar, edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet miratimin e këtij ligji edhe në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, shumë!

Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli, nga LDD.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet Raportin e Komisionit ad-hoc dhe do të votojë “për”. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit!

Sipas radhës, vjen përfaqësuesi i Grupit “7+”. Kush do ta marrë fjalën? Nuk qenkan këtu!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së? Faleminderit!

Në monitor nuk kam ndokënd të jetë lajmëruar për debat. Atëherë, shkojmë në procedurën e votimit.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 70 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim – miratohet Ligji për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Të nderuar deputetë, me këtë votim përfundon seanca e sotme. Mirupafshim në seancën e ardhës.

E përgatiti:

Njësia e Transkripteve